ANKESE - OSHP

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA HANI I ELEZIT

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**659-26-6002-5-2-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: "Ndriqimi publik ne fshatrat Pustenik, Dimce, Gorance, Krivenik, Seçishte, Rezhance, Paldenice, Dernjak".

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

OE :Energy A+ SH.P.K

Add: Veternik - Prishtine

Vendi: Prishtine

Tel: 049880485

energyaplus@outlook.com

18.11.2026

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me dt. 22.07.2026

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 12.10.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ Jo ☒ X

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ X Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për

Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së **Neni 7 i LPP-së** **Neni 27 i LPP-së** **Neni 59 i LPP-së** **Neni 60 i LPP-së** **Neni 61 i LPP-së** **Neni 69 i LPP-së** **Neni 18.9 i RRUOPP-së** **Neni 26.4 i RRUOPP-së** **Neni 39.3 i RRUOPP-së** **Neni 39.4 i RRUOPP-së** **Neni 39.5 i RRUOPP-së.**

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Të nderuar AK- ju me dt. 03.11.2026 keni publikuar Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues, me titull: **"Ndriqimi publik ne fshatrat Pustenik, Dimce, Gorance, Krivenik, Seçishte, Rezhance, Paldenice, Dernjak**

Operatori Ekonomik Energy A+ SH.P.K. paraqet këtë Ankesë kundër veprimeve dhe vendimit të Autoritetit Kontraktues, për shkak të mosshqyrtimit të mirëfilltë të kërkesës për rishqyrtim dhe cenimit të së drejtës ligjore të operatorit ekonomik për një shqyrtim të drejtë, objektiv dhe të arsyetuar.

Konsiderojmë se vendimi i marrë nga Autoriteti Kontraktues është i padrejtë dhe i pabazuar, pasi vlerësimi dhe eliminimi i ofertës sonë nuk janë në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë në prokurimin publik.

Një përgjigje e tillë nuk mund të konsiderohet shqyrtim real dhe substancial i kërkesës për rishqyrtim. Autoriteti Kontraktues ka detyrim ligjor që të trajtojë secilin pretendim të ngritur, të analizojë provat dhe dokumentet e paraqitura dhe të japë arsyetim konkret për pranimin apo refuzimin e tyre.(Te cilen nuk e ka bere)

Nuk mjafton që Autoriteti Kontraktues vetëm të deklarojë se nuk ka shkelje; ai duhet të dëshmojë dhe arsyetojë se përse pretendimet tona nuk qëndrojnë.

Mosadresimi i pretendimeve konkrete dhe refuzimi përmes një përgjigjeje të përgjithshme cenon transparencën, llogaridhënien dhe të drejtën e operatorit ekonomik për mbrojtje juridike efektive.

Për më tepër, një qasje e tillë krijon përshtypjen se kërkesa për rishqyrtim është trajtuar vetëm formalisht, pa u analizuar fare përmbajtja dhe argumentet e saj.

Për këto arsye, kërkojmë nga OSHP-ja që të shqyrtojë me kujdes këtë ankesë, të vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve të Autoritetit Kontraktues dhe të mos lejojë që e drejta ligjore për

rishqyrtim të reduktohet në një përgjigje formale, pa trajtim dhe pa arsyetim të pretendimeve të operatorit ekonomik.

KERKESA 1 - Lista e mjeteve te punes dhe ate se 2 kamioneta me autoshport (me testime), 1 Eskavator
OE duhet te ofroj listen e mjeteve te punes te nenshkruar dhe vulosur ne origjinal te deshmuar me Librezat e qarkullimit ose Dudin Doganor . Çertifikatat e testimeve duhet te jene kopje valide . Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët
PRETENDIMI 2 - **Ne listën te cilën e keni ofruar sa i perkete mjeteve te punës ju keni listar vetëm nje mjet kamionët dhe po te njëjtit i mungone A-testi (A-testin te cilën e keni bashkangjitur per kete automjet 03-811-JD, filloin per kete kuse maron per nje automjet te cilën ju nuk e keni te prezentuar ne list dhe as tek dëshmi si librez te re. Ju nuk keni permusher kërkesën ne baze te DT kamionët me shkorte 2 cope**

PERGJIGJIE 1 – 1 : Autoriteti Kontraktues, në arsyetimin e vendimit për eliminimin e Operatorit Ekonomik, ka pretenduar se A-testi i paraqitur për automjetin me numër regjistrimi 03-811-JD nuk mund të merret në konsideratë, me arsyetimin se në raportin e testimit figuron një automjet tjetër, i cili nuk është evidentuar në listën e mjeteve të punës dhe për të cilin nuk është dorëzuar libreza e qarkullimit.Konkretisht, Operatori Ekonomik ka paraqitur në listën e mjeteve të punës kamionetën me numër regjistrimi 03-811-JD, ndërsa në raportin e A-testit, për shkak të gabimit gjatë evidentimit të të dhënave nga kompania testuese, është shënuar nje nr tjeter.Theksojmë se kjo pasaktësi nuk është shkaktuar nga Operatori Ekonomik dhe nuk përbën mungesë të automjetit apo të dëshmisë së testimit, por është një gabim administrativ dhe teknik i palës së tretë, e cila ka qenë përgjegjëse për lëshimin e dokumentit.Pas identifikimit të gabimit, Operatori Ekonomik ka kontaktuar kompaninë testuese, e cila ka pranuar përgjegjësinë për pasaktësinë e bërë, ka kërkuar falje dhe ka ndërmarrë veprimet për korrigjimin e raportit. Për këtë arsye, bashkëngjitur kësaj kërkese paraqitet dokumentacioni korrigjues dhe sqarimi zyrtar i kompanisë testuese, përmes të cilit konfirmohet origjina e gabimit teknik.

Në këtë rast, Autoriteti Kontraktues është dashur të kërkojë sqarim për mospërputhjen e evidentuar, veçanërisht duke pasur parasysh se automjeti 03-811-JD ishte i paraqitur në listën e mjeteve të punës dhe se A-testi ishte dorëzuar së bashku me ofertën.

Eliminimi i një Operatori Ekonomik për një gabim teknik të një pale të tretë, i cili është pranuar dhe korrigjuar nga vetë pala përgjegjëse, pa u bërë përpjekje për sqarimin dhe verifikimin e tij, nuk përbën vlerësim të drejtë dhe objektiv të dokumentacionit të ofertës.

Bashkangjitur gjeni raportin e testimit, ku ne fund sqarohet kjo pike nga Kompania e autorizuar .

RT M05.1 2026 CAPITAL FET- KAMIONI ME PLATFORMË PËR PUNË NË LARTËSI.pdf

PERGJIGJIE 1 – 2 : Lidhur me vlerësimin e mjeteve të punës dhe pretendimin për mungesën e dy kamionetave
Në arsyetimin e vendimit, Autoriteti Kontraktues pretendon se Operatori Ekonomik ka paraqitur vetëm një mjet të kategorisë kamionetë dhe se nuk është përmbushur kërkesa për dy mjete të tilla.Ky konstatim nuk paraqet një vlerësim të plotë dhe objektiv të dokumentacionit të ofertës sonë.ENERGY A+ SH.P.K. ka paraqitur dokumentacionin për tri automjete pune, të gjitha të pajisura me platformë ngritëse (autoshport), përkatësisht:

1. Një automjet të kategorisë furgon me autoshport.
2. Një automjet të kategorisë kamionetë me autoshport.
3. Një automjet të kategorisë kamion me autoshport.

Të gjitha këto mjete janë paraqitur si mjete pune për realizimin e aktiviteteve të kontratës dhe janë shoqëruar me dokumentacionin përkatës të regjistrimit dhe dëshmitë e testimit teknik të platformave ngritëse.(TE GJITHA TE VENDOSURA NE LISTEN E MJETEVE 6_ LISTA E MJETEVE) Në këtë drejtim, konsiderojmë të rëndësishme të theksojmë se Testimi teknik ka për objekt platformën ngritëse (autoshporten), përkatësisht pajisjen që mundëson realizimin e punëve në lartësi dhe që paraqet funksionin **kryesor të këtij mjeti në kuadër të kontratës**.Pra, elementi teknik që kërkohet të dëshmohet përmes atestimit është siguria dhe përshtatshmëria e platformës ngritëse, e jo emërtimi i automjetit bazë në të cilin është montuar kjo platformë. Funksioni i platformës ngritëse nuk ndryshon varësisht nëse ajo është e montuar në furgon, kamionetë apo kamion.Për më tepër, Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit nuk ka përcaktuar parametra të tjerë teknikë të automjetit bazë, si pesha, gjatësia, dimensionet, kapaciteti bartës apo karakteristika të tjera specifike, të cilat do të mund të shërbenin si bazë për një dallim të tillë në aspektin teknik dhe funksional.Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë analizë teknike lidhur me përshtatshmërinë e tri mjeteve të paraqitura, pajisjen e tyre me platforma ngritëse, atestimin teknik dhe mundësinë e përdorimit të tyre për realizimin e punëve të parapara në kontratë.
Në vend të një vlerësimi të tillë, AK është mbështetur kryesisht në emërtimin formal të automjeteve, pa argumentuar se përse mjetet e tjera të paraqitura, të pajisura me platforma ngritëse të testuara dhe të dokumentuara, nuk mund të konsiderohen të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve të kontratës.

Për më tepër, pikat 39.3, 39.4 dhe 39.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik përcaktojnë mundësinë e sqarimit të dokumentacionit dhe pranimit të dëshmive plotësuese, kur ato dëshmojnë objektivisht një gjendje ekzistuese para afatit përkatës, pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës.

Neni 1 i LPP-së përcakton qëllimin e sigurimit të përdorimit efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike, ndërsa Neni 7 përcakton parimet e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë. Rrjedhimisht, konsiderojmë se eliminimi i ofertës sonë pa një shqyrtim të plotë të dokumentacionit të tri automjeteve, atesteve teknike dhe funksionalitetit të platformave ngritëse nuk përbën një vlerësim të mjaftueshëm dhe objektiv të ofertës.

Për këto arsye, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të bëjë rivlerësimin e plotë të dokumentacionit të tri automjeteve të paraqitura nga ENERGY A+ SH.P.K., duke analizuar dëshmitë e regjistrimit, atestet e platformave ngritëse dhe përmbushjen reale të kërkesave teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit, në përputhje me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë.
Gjithashtu, theksojmë se edhe vetë Autoriteti Kontraktues, në procedurat e mëparshme të prokurimit, në Dosjet e Tenderit ka kërkuar vetëm autoshportin (platformën ngritëse), pa i kushtuar rëndësi të veçantë kategorisë apo emërtimit të automjetit bazë ku është montuar ai. Kjo dëshmon se elementi kryesor për realizimin e punimeve ka qenë funksionaliteti dhe pajisja me platformë ngritëse, e jo domosdoshmërisht klasifikimi apo emertimi i automjetit si furgon, kamionetë apo kamion. Për rrjedhojë, është e paarsyeshme që në këtë procedurë të përdoret një interpretim më kufizues, pa ndonjë arsyetim teknik dhe pa një kërkesë të qartë të përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Theksojmë se çështja e mjeteve të punës dhe përshtatshmërisë së tyre me natyrën e punimeve ka qenë më herët objekt shqyrtimi nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), për të cilën është nxjerrë Vendimi nr. 2026/0591, i datës 21.09.2026. Për këtë arsye, kërkojmë që OSHP-ja ta marrë parasysh edhe këtë vendim , duke siguruar që kërkesat për mjete të interpretohen dhe vlerësohen në përputhje me natyrën dhe funksionin real të punimeve që janë objekt i kontratës.

- **Ne lidhje me qasjen ne dokumentacionin e kompanise fituese “LCE Sh.P.K”**

1.- Pas kerkeses per qasje ne dokumentacionin e kmpanise se rekomanduar fituese me daten 06.11.2026, ne kundershtojme fuqishëm rekomandimin për kontratë te OE: LCE SH.P.K për shkak të çmimeve haptazi abuzive dhe joreale të paraqitura nga operatori ekonomik i rekomanduar në pozicionet bazë të projektit të ndriçimit publik, konkretisht:

Cmime normalisht te ulet:

Respektivisht ne te gjitha pozicionet nga pika B. Ndriqimi publik ne shtylla Betoni (Komplet nga paramasa) dhe pika C.Auditimi-Dizajnimi

- Trupi ndriçues LED 60W – **20.00 €**
- Shtylla e betonit 9m – **0.10 €**
- Ormani shpërndarës i ndriçimit – **1.00 €**

Cmime normalisht te larta, pika A. Ndriqimi publik ne shtylla metalike –

Cmimi i nje shtylle **600€**

Ormani shpërndarës i ndriçimit tek lista e cmimeve pozicon A – pika 1.1.7, cmimi njesi eshte **500** euro, ndersa, tek pozicioni B, pika 2.1.2, ku eshte produkti identik ka ofruar me cmim **1** euro.

Vendosja e këtyre çmimeve është ekonomikisht e pajustifikueshme dhe ngre dyshime serioze për manipulim të strukturës së paramasës dhe ofertim me çmime abuzive. Është e papranueshme që pozicionet kryesore dhe të domosdoshme për realizimin e projektit të paraqiten me çmime kaq joreale dhe të shkëputura nga vlerat reale të tregut. Po ashtu eshte ne kundershtim te plote me LPP-ne, ku operatori ekonomik nuk lejohet te ofroj cmime jo normalisht te ulta ose jo normalisht te larta. Kjo eshte e verifikushme fare lehte duke krahasuar ofertat financiare te operatoreve tjeter pjesemarres.

Kërkojmë nga OSHP-ja verifikim të menjëhershëm dhe të detajuar të këtyre çmimeve, të rekomandimit për kontratë. Nuk mund të konsiderohet ofertë e besueshme një paramasë që përmban çmime kaq ekstreme dhe potencialisht abuzive, veçanërisht kur operatori i rekomanduar ka ofertuar **5,981.50 € më shumë** se ENERGY A+ SH.P.K.

Për më tepër, kjo mënyrë e ofertimit rrezikon drejtpërdrejt përdorimin joefikas të parasë publike, duke favorizuar një ofertë me vlerë më të lartë dhe me çmime të pozicioneve bazë që nuk reflektojnë realitetin e tregut. **Është e papranueshme që buxheti publik të ngarkohet me kosto më të larta, ndërkohë që pozicionet kryesore të paramasës paraqiten me çmime artificiale dhe ekonomikisht të pajustifikueshme.**

2.- Parregullsitë në raportin e Komisionit për Vlerësimin e Ofertave dhe mungesa e nënshkrimit të kryesuesit të Komisionit
Pas ushtrimit të së drejtës për qasje në dokumentet e aktivitetit të prokurimit, kemi vërejtur një parregullsi tjetër serioze në dokumentacionin e vlerësimit, konkretisht në raportin e Komisionit për Vlerësimin e Ofertave.
Nga dokumentet e siguruara rezulton se raporti i Komisionit nuk përmban nënshkrimin e kryesuesit të Komisionit, rrethanë kjo e cila ngre pikëpyetje serioze lidhur me përfshirjen, pjesëmarrjen dhe miratimin e procesit të vlerësimit nga ana e të gjithë anëtarëve të Komisionit.
Mungesa e nënshkrimit të kryesuesit nuk është një çështje që mund të anashkalohet si formalitet administrativ, pasi raporti i vlerësimit duhet të pasqyrojë një proces real, dhe të dokumentuar, ku përgjegjësitë dhe konstatimet e Komisionit janë të qarta.
Në këtë rrethanë, lindin dyshime të arsyeshme nëse Komisioni ka ushtruar realisht përgjegjësitë e tij në vlerësimin e ofertave, nëse raporti është shqyrtuar dhe miratuar nga anëtarët përkatës, apo nëse procesi i vlerësimit është zhvilluar dhe përfunduar në praktikë vetëm nga Zyrtarja e Prokurimit, pa një përfshirje dhe kontribut të dokumentuar të plotë të Komisionit.
Kjo çështje bëhet edhe më shqetësuese kur merret parasysh se Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim, nuk ka trajtuar fare pretendimet tona konkrete, duke u kufizuar vetëm në deklarimin e përgjithshëm se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të operatorëve ekonomikë.

Për këtë arsye, kërkojmë nga OSHP-ja që të verifikojë:
- Pse raporti i Komisionit nuk përmban nënshkrimin e kryesuesit të tij?
- A ka marrë pjesë kryesuesi në procesin e vlerësimit dhe a ka qenë në dijeni për përmbajtjen përfundimtare të raportit?
- A është raporti shqyrtuar dhe miratuar nga të gjithë anëtarët e Komisionit?

- Kush e ka hartuar dhe kush e ka miratuar përfundimisht raportin e vlerësimit?
- A është respektuar ndarja e përgjegjësive ndërmjet Komisionit për Vlerësimin e Ofertave dhe Zyrtarit të Prokurimit?
Kërkojmë që OSHP-ja të mos e trajtojë këtë si një mangësi të thjeshtë formale, por të verifikojë nëse kemi të bëjmë me një proces vlerësimi të zhvilluar në përputhje me kërkesat ligjore dhe parimet e prokurimit publik.*(Bashkangjitur munde te gjeni raportin e Komisjonit)*

PERFUNDIM: Është tejet shqetësuese dhe e papranueshme që ENERGY A+ SH.P.K., si operator ekonomik me ofertën me çmimin e përgjithshëm më të ulët, të eliminohet pa asnjë sqarim bindës dhe pa asnjë arsyetim konkret e të mbështetur në fakte, ndërsa operatorit ekonomik LCE SH.P.K të rekomanduar për kontratë, me çmim **5,981.50 € më të lartë**, t'i mundësohet përfitimi i kontratës, pavarësisht çmimeve dukshëm abuzive dhe të pajustifikueshme në pozicionet kryesore të paramasës.

Një qasje e tillë ngre dyshime serioze mbi objektivitetin dhe konsistencën e vlerësimit të ofertave, krijon hapësirë për përdorim joefikas të parasë publike dhe lë pikëpyetje të mëdha lidhur me mundësinë e realizimit real dhe cilësor të projektit sipas çmimeve të paraqitura.

Këto veprime konsiderojmë se janë në kundërshtim me **nenin 1 të LPP-së**, i cili përcakton përdorimin efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike; **nenin 7**, i cili garanton trajtimin e barabartë dhe ndalon diskriminimin e operatorëve ekonomikë; **nenin 59**, i cili obligon Autoritetin Kontraktues të bëjë ekzaminimin dhe vlerësimin e drejtë të ofertave; si dhe **nenin 60**, i cili përcakton kriteret ligjore për dhënien e kontratës.

Është e papranueshme që operatori me ofertën më të lirë të eliminohet pa arsyetim të qëndrueshëm, ndërsa oferta më e shtrenjtë, me çmime ekstreme dhe të pabalancuara, të rekomandohet për kontratë pa një verifikim të mirëfilltë ekonomik dhe teknik.

Mbi të gjitha, prioriteti kryesor i Autoritetit Kontraktues duhet të jetë realizimi i plotë, cilësor dhe i qëndrueshëm i projektit, e jo thjesht rekomandimi formal i një operatori ekonomik për kontratë. Përzgjedhja duhet të garantojë se punët dhe furnizimet do të realizohen realisht, sipas specifikimeve teknike dhe çmimeve të arsyeshme, duke mbrojtur interesin publik dhe paranë e taksapaguesve.

VENDIM

APROVOHET- Kërkojmë nga OSHP-ja që Ankesen ta aprovojë si të bazuar, në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe Rregullat e Prokurimit Publik

NDRYSHOHEN - Të ndryshojë vendimin e nxjerrë nga Autoriteti Kontraktues, duke i eliminuar shkeljet e konstatuara dhe duke vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*